



QËR 2021



TITUJT

Editorial: Bashkëpunimi rajonal **faqja 1**

Aktivitetet tjera të OKB-së **faqet 2 & 3**

**Strategjia Nacional për
Zhvillim** **faqja 4**

Në fokus **faqja 4**

DATAT KYÇE

QËRSHOR

- 3-17** UN Women i mbështeti komunat e Kumanovës, Gazi Babës dhe Gjorce Petrov në zhvillimin e strategjive dhe planeve të veprimit për barazinë gjinore përmes punëtorëve të planifikimit strategjik me grupet ndër-sektoriale të punës për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor
- 4** FAO dhe Kabineti i Zëvendëskryeminitrist të Qeverisë përgjegjës për çështje ekonomike, organizuan një punëtori për verifikimin e Vlerësimit të nevojave për ndryshimet klimatike në kontekstin e zhvillimit të programit të punës të Fondit të Gjelbër të Klimës (FGJK) për Maqedoninë e Veriut.
- 7** eveniment i përbashkët në internet i FAO-s dhe OBSH-së me rastin e Ditës Botërore të Sigurisë së Ushqimit - "Siguria e ushqimit në kontekstin e sistemeve të qëndrueshme të ushqimit: Ecja përpara për një të nesërme të shëndetshme në Evropë dhe Azinë Qendrore".
- 7-11** Projekti për Komunikimin i Aeroportit UNODC-WCO-INTERPOL (AIRCOP) zhvilloi një takim me zyrtarë të lartë nga Maqedonia e Veriut dhe INTERPOL-i në lidhje me përfundimin e hapave të ardhshëm të krijimit të Task Forcës së përbashkët të aeroportit për ndalime (JAIF) në Aeroportin Ndërkombëtar të Shkupit.
- 8-29** FAO dhe autoriteti përkatës nacional organizuan diskutime në fokus grupe me subjekte të sektorit privat mbi financimin e klimës dhe investimet në kontekstin e Fondit të Gjelbër të Klimës.
- 11** UNODC zhvilloi takim me Prokurorët nga Prokuroria e Përgjithshme e Maqedonisë së Veriut për të diskutuar ngjarje të përbashkët në lidhje me shkëmbimin ndër-institucional të informacioneve, që kanë të bëjnë me armët e zjarrit.
- 23** Punëtori për buxhetet e përgjegjshme gjinore për Klubin e grave deputete dhe Komisionin për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat

EDITORIAL Koordinator i përhershëm i OKB-së

Bashkëpunimi rajonal është aspekt qenësor i zhvillimit të qëndrueshëm, pasi mund ta përshpejtojë rritjen e ekonomisë, të sigurojë zhvillim paqësor dhe prosperitet, si dhe të sigurojë zgjidhje për çështje që i tejkalojnë dimensionet e kufijve, andaj jam e lumtur që kohëve të fundit janë ndërmarrë disa iniciativa të mirëfillta rajonale. Këtu vlen të përmenden disa prej tyre - heqja e fundit e tarifave të roamingut në Ballkanin Perëndimor, ose procedurat e thjeshtuara për kalimin e kufijve. Të gjitha këto nisma, të akorduara mes udhëheqësve të rajonit, sjellin përmirësime të prekshe në cilësinë e jetës së të gjithë qytetarëve në të gjithë rajonin dhe janë një përshpejtues i shkëlqyeshëm për zhvillimin ekonomik.

Gjithashtu një shembull i shkëlqyeshëm është konferenca e fundit e "Forumit të Prespës për Dialog", e cila mbledhi drejtues nga sferat politike, ekonomike dhe të shoqërisë civile, si dhe të rinj nga i gjithë rajoni, Evropë dhe më gjerë. Kjo është konferenca më e madhe ndërkombëtare e organizuar nga Maqedonia e Veriut, e cila e hap një platformë të re të rëndësishme për dialogun dhe ndërtimin e urave midis vendeve në Ballkanin Perëndimor dhe më gjerë, duke promovuar zgjidhje paqësore, konsensuale - dhe të bazuara në dialog për çështjet e hapura të bashkëpunimit rajonal. Në këtë drejti dëshiroj ta përgëzoj Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Qeverinë e Maqedonisë së Veriut për iniciativën e tyre dhe organizimin e suksesshëm të kësaj Konference, e cila i afron edhe më tepër vendet nga rajoni.

Jo më pak i rëndësishëm është bashkëpunimi ndërkufitar në lidhje me mjedisin. Me rreziqet në rritje nga ndryshimi i klimës, si mungesa e ujit dhe katastrofat më të rënda natyrore, bashkëpunimi rajonal në këtë fushë do të vazhdojë të ketë peshë gjithnjë e më të madhe. OKB-ja punon në tre shtete për ta zhvilluar menaxhimin e integruar të rreziqut nga përmblytjet për pellgun e lumit Drin, si një masë e përshtatjes së ndryshimit të klimës. Bashkëpunimi më i madh ndërkufitar në menaxhimin e liqeneve të Ohrit, Prespës dhe Dojranit është gjithashtu një sfidë e rëndësishme, që duhet trajtuar gjatë periudhës në vijim.

Ekziston edhe kontributi i rëndësishëm i të rinjve në zhvillimin e qëndrueshëm dhe paqësor rajonal. Falë potencialit të tyre të madh, OKB-ja e promovon angazhimin e të rinjve, aktivizmin dhe veprimin për ndryshim. Ne i bashkojmë forcat në krijimin e mundësive, që të dëgjohet zëri i të rinjve dhe të ndikohet në udhëheqjen dhe sfidat rajonale në mënyra inovative dhe krijuese, përmes iniciativave si Zyra Rajonale e Bashkëpunimit Rinor (RYCO), Rrjeti i Edukimit për Kolegjet

e të Rinjve (Y-Peer), Programi Rajonal për Demokraci Lokale (ReLQoaD) dhe të tjerë. Kjo iniciativë përqendrohet në ndikimin afatgjatë, synon nxitjen e besimit dhe kohezionit brenda dhe në të gjitha komunitetet në Ballkanin Perëndimor duke i fuqizuar të rinjtë për t'i përfqaruar vlerat e diversitetit, tolerancës dhe përfshirjes. Bazuar në modelin Y-Peer, të rinjtë me sfond të ndryshëm, veçanërisht ata që janë të vështirë për t'u gasur, kanë një mundësi të takohen, miqësohen dhe të mësojnë nga kolegët e tyre se si të ndërtojnë dhe mbajnë një mjedis të sigurt dhe paqësor dhe të ndërtojnë ura të qëndrueshme midis tyre dhe vendet e tyre.



Sigurisht, ka shumë më tepër gjëra që mund të bëhen. Shumë punë është akoma përpara nesh në drejtim të projekteve më të mëdha të infrastrukturës për të siguruar transferim të lehtë të mallrave dhe udhëtime në të gjithë rajonin. Mund të bëhet më shumë punë në drejtim të shkëmbimit kulturor, përmirësimit të ofertave turistike me qasjen rajonale ose përmirësimit të procedurave administrative që mund ta përshpejtojnë dhe forcojnë tregtinë, investimet dhe bashkëpunimin përtej kufijve. Këto janë të gjitha segmentet që mund të kenë ndikim të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të të gjitha vendeve në rajon, si dhe të të gjithë rajonit.

Përfundimisht, ekziston potenciali për shkëmbim më të madh në trajtimin e çështjeve të zakonshme, si varfëria, diskriminimi, papunësia ... Duhet të ndahen me fqinjët praktikatat e mira, së bashku me mësimet e marra nga aktivitetet që nuk ishin të suksesshëm. Unë besoj se në fund të fundit të gjitha qeveritë në rajon i kanë të njëjtat qëllime - ta përmirësojnë jetën dhe rezultatet e të gjithë njerëzve që jetojnë në këto vende. Duke rritur shkëmbimin midis tyre, midis të gjithë neve, në frymën e Qëllimit të Zhvillimit të Qëndrueshëm 17, do të mund të sigurohemi që askush të mos ngel pas

Rossana Duxhak
Koordinator i Përhershëm i OKB-së në Maqedoninë e Veriut

AKTIVITETET TJERA TË OKB-SË

Zyra e Kombeve të Bashkuara për shërbimet e projektit (UNOPS) ka prokuruar dhe dorëzuar pajisje të reja për kryerjen e analizave mjedisore në Laboratorin për analizën kromatografike të Institutit të Kimisë. Pajisjet me vlerë 94,000 dollarë janë dhuruar nga Mbretëria e Norvegjisë përmes projektit Ndihma Nordike për Progresin e Maqedonisë së Veriut dhe do të përdoren për monitorimin dhe kontrollimin e pavarur të efekteve mjedisore të procesit të pastrimit të depozitave të lindanit në OHIS (IKOSH). Laboratori ka marrë lloje të ndryshme të pajisjeve të tilla si kromatograf gaz, mostra, koncentruar, vegla laboratorike, tretës dhe standarde që do të sigurojnë monitorim të rregullt të qeverisë kundër COVID-19 e kanë zburat ndikimin në varfërinë ekstreme të fëmijëve, prapëseprapë më shumë fëmijë jetojnë nën standardin mesatar të jetesës. Për më tepër, ndërprerjet në shërbimet e mbrojtjes sociale dhe arsimit dhe kërkesa e zvogëluar në shërbimet shëndetësore po i vënë fëmijët në rrezik të mëtejshëm, pasi është duke zgjatur pandemia. Videot dhe infografikë dinamike u publikuan në mediat sociale, ku edhe u portretizuar disa nga rezultatet aktuale dhe rekomandimet.

Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), në partneritet me USAID-in dhe Finance Think e publikoi një [azhurnim të analizës](#) së efekteve sociale dhe ekonomike të COVID-19 ndaj fëmijëve, që herën e parë ishte prezantuar në korrik të vitit 2020. Ndonëse masat socio-ekonomike të qeverisë kundër COVID-19 e kanë zburat ndikimin në varfërinë ekstreme të fëmijëve, prapëseprapë më shumë fëmijë jetojnë nën standardin mesatar të jetesës. Për më tepër, ndërprerjet në shërbimet e mbrojtjes sociale dhe arsimit dhe kërkesa e zvogëluar në shërbimet shëndetësore po i vënë fëmijët në rrezik të mëtejshëm, pasi është duke zgjatur pandemia. Videot dhe infografikë dinamike u publikuan në mediat sociale, ku edhe u portretizuar disa nga rezultatet aktuale dhe rekomandimet.

Në një letër të hapur për të gjithë pretendentët e zyrave lokale, Përfaqësuesja e UNICEF, Patricia Di Xhovani inicioi një dialog dhe bëri thirrje për t'i vënë fëmijët dhe të rinjtë në rend të parë të zgjedhjeve të ardhshme lokale.

Në kuadër të një trajnimi më shumë se 50 përfaqësues të organizatave të personave me aftësi të kufizuara, qeverisë, agjencive të OKB dhe palëve tjera të rëndësishëm, si dhe personave me aftësi të kufizuara, e forcuan kuptimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPA) dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të aftësive të kufizuara (OZhQ). Ky trajnim u zhvillua mes 18 dhe 28 maj, 2021 dhe e ndoqi metodologjinë e zhvilluar globale të UNPRPD-së. Trajnimi ndihmoi në zhvillimin e një kuptimi të përbashkët të pjesëmarrësve në qasjet ndërsektoriale që i mbështesin programet e përbashkëta të UNPRPD-së,



UNOPS ka prokuruar dhe dorëzuar pajisje të reja për kryerjen e analizave mjedisore në Laboratorin për analizën kromatografike

duke i vendosur bazat për dy komponentët e ardhshëm të fazës fillestare: analiza e situatës dhe zhvillimi i propozimit të projektit.

Në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë, UNICEF-i e ka finalizuar digjitalizimin e sistemit të regjistrimit dhe raportimit dhe lidhjen e tij me modulet e tjera në "Moj termin" (Takimi im). Këto module pritet të jenë funksionale që në fillim të qershorit të vitit 2021. Udhëzuesi i prindërve gjithashtu është digjitalizuar dhe do të sigurojë ndihmë shtesë për familjet me foshnja të sapolindur se si ta ndjekin shëndetin dhe zhvillimin e fëmijëve.

UNICEF-i e përfundoi me sukses fazën e tretë të ndërhyrjeve të sjelljes për ta rritur marrjen e vaksinës MMR (prototipet përfshijnë afişe me informacione dhe fletëpalosje për prindërit në dhomat e pritjes dhe vaksinimit, si dhe material përkujtes për stafin mjekësor me pyetjet e parashtruara më së shpeshti). Pritet të përfundohet raporti përfundimtar me rekomandime për materialet e shpërndara në të gjithë vendin.

Në maj dhe qershor 2021, UNICEF-i në Maqedoninë e Veriut dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) organizuan trajnimin e trajnerëve për 36 profesionistë nga pesë qendrat e burimeve në të gjithë vendin, për t'i mbështetur më tej këto qendra në funksionin e tyre të ri, si lehtësues të procesit të përfshirjes në shkollat fillore. Trajnimi, i cili u zhvillua në 12 seanca trajnimi në internet, synonte t'i forconte njohuritë e pjesëmarrësve për praktikën e arsimit gjithëpërfshirës dhe t'i

forconte aftësitë e tyre lehtësuese, për t'i përgatitur më mirë ata për rolin e tyre në punësim, në trajnimin dhe menaxhimin e ndihmës arsimore në shkolla të siguruar nga shteti. Transformimi i ish shkollave speciale në qendra burimore për shkollat e zakonshme dhe mësuesit është pjesë e një reforme arsimore të mbështetur nga UNICEF-i, që u intensifikua me miratimin e ligjit për arsimin fillor në vitin 2019, i cili parashikon që deri në vitin 2023, të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara në Maqedoninë e Veriut të përfshihen në arsimin e zakonshëm.

Si pjesë e programit të mbështetur nga UNICEF mbi mjedisin dhe edukimin për ndryshimin e klimës, të financuar nga Qeveria e Suedisë (SIDA), u promovua faqja e internetit [www.climateedu.mk](#) në të cilën mbi 350 njerëz u zotuan për ta mbështetur mjedisin dhe iniciativat e ndryshimeve klimatike.


Gjetjet e reja të hulumtimit u publikuan më 7 qershor nga UNICEF-i, ku u theksua fakti se fëmijët që e kanë ndjekur fizikisht mësimin gjatë vitit shkollor 2020/2021 kanë përjetuar më pak vështirësi pavarësisht nga koha më e shkurtër e udhëzimit, dhe se ata kanë qenë në gjendje t'u përmbahen protokolleve të sigurisë kundër COVID-19. Këto zbulime së bashku me të dhënat tjera mbi ["Përvojat dhe qëndrimet ndaj mësimin në distancë"](#), të prezantuara gjatë pandemisë COVID-19 e theksojnë rëndësinë e përgatitjes për rihapje të shkollave në shtator për të gjithë fëmijët.

Gjatë qershorit dhe korrikut, [UNICEF-i në Partneritet me Kabinetin e Presidentit të Maqedonisë së Veriut](#) do të zhvillojë një seri të Konsultimeve rinore, duke iu dhënë fëmijëve dhe të rinjve hapësirën për t'u angazhuar në përcaktimin e vizionit, që ata e duan për të ardhmen dhe gjeneratat e tyre të ardhshme.

UNICEF në partneritet me Qendrën Kulturore Rinore zhvilloi një eko-program që do të prezantohet gjatë Festivalit të Filmit Evropian në Shkup Cinedays që do të mbahet nga 15 deri më 21 korrik). Do të shfaqen eko-filmat vendor dhe ndërkombëtarë, si dhe do të organizohet një panel diskutimi me ekspertë dhe krijues të filmave. Gjithashtu pjesë e Festivalit do të jetë këndi Reuse & Repair Chill (ripërdor dhe riparim), i përbërë nga materiale të mbeturinave.

Zyra e UN Women për Maqedoninë e Veriut mori pjesë në mbledhjen e parë rajonale të Ballkanit Perëndimor të projektit për Mekanizmin e barazisë gjinore që u zhvillua në Neum, Bosnjë e Hercegovinë (10-11 qershor, 2021).

UN Women e zgjeroi mbështetjen për zbatimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në proceset lokale të politikëbërjes



UNICEF mbi mjedisin dhe edukimin për ndryshimin e klimës, të financuar nga SIDA, u promovua faqja e internetit [www.climateedu.mk](#)

AKTIVITETET TJERA TË OKB-SË

dhe buxhetimit përmes nënshkrimit të Memorandumi të mirëkuptimit me 10 komuna të reja: Karposhin, Strugën, Staro Nagoričanin, Makedonska Kamenicën, Vinicën, Gjevgjelinë, Çashkën, Dellçevën, Makedonski Brodin dhe Kavadarin. Në muajin qershor UN Women organizoi një trajnim tre ditor për 23 përfaqësues nga 10 NJVL për forcimin e njohurive të tyre mbi integrimin e gjinisë në politikat dhe buxhetet lokale. Trajnimi ishte pjesë e projektit "Promovimi i politikave dhe buxheteve të përgjegjshme gjinore: Drejt qeverisjes transparente, gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut", i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar - Sida.

UN Women dhe Enti Shtetëror i Revizionit (EShR) e nënshkruan një Memorandum mirëkuptimi në kuadër të projektit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, i cili do të sigurojë një kornizë për forcimin e kapaciteteve të EShR-së dhe zbatimin sistematik të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në aktivitetet e rregullta dhe planet e auditimit vjetor. Në qershor, mbi 90 auditorë dhe punonjës në EShR morën pjesë aktive në trajnimet e organizuara në kuadër të projektit. Më shumë aktivitetet dhe trajnime janë planifikuar për ta forcur më tej rolin e EShR-së në realizimin e auditimeve gjinore.

HERA organizoi serinë e pestë dhe të fundit të trajnimeve për fuqizimin e kapaciteteve të OShC-ve në drejtim të ofrimit të shërbimeve të specializuara për të mbijetuarit e dhunës. HERA është një organizatë partnere për UN Women brenda projektit rajonal EVAW, të financuar nga Bashkimi Evropian.

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut organizoi një trajnim dy ditor për fuqizimin e kapaciteteve të OShC-ve për monitorimin e zbatimit të Konventës së Stambollit dhe për përpilimin e raporteve në hije të GREVIO. Komiteti i Helsinkit është një organizatë partnere e UN Women brenda projektit rajonal EVAW, të financuar nga Bashkimi Evropian.

Për kremtimin e "Ditës Botërore pa duhan" (31 maj çdo vit), **Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH)** organizoi një ngjarje në partneritet me Institutin e Shëndetit Publik, gjatë së cilës u prezantuan të dhënat për përdorimin e duhanit në Maqedoninë e Veriut dhe në botë dhe u promovua pakoja e OBSH-së për braktisjen duhanit. Shënimi i ditëve të tjera përmes mediave sociale përfshinte Ditën Botërore të biçikletave (3 qershor), Ditën Botërore të mjedisit (5 qershor), Ditën Botërore të sigurisë ushqimore (7 qershor) dhe Ditën Botërore të dhuruesve të gjakut (14 qershor).



Ditës Botërore pa duhan - OBSH

Më 17 qershor, dr. Xhahane Tavilah, Përfaqësuesja e OBSH-së në Maqedoninë e Veriut u takua me përfaqësuesit e Shoqatës Maqedonase të Infermierëve dhe Mamive dhe mori një pllakë vlerësimi për mbështetjen e vazhdueshme të OBSH-së për profesionin e infermierisë në vend. Viti 2020 ishte caktuar nga OBSH-ja si viti i infermierëve dhe mamive, ndërsa viti 2021 si viti ndërkombëtar i punëtorëve të shëndetit dhe kujdesit, si shenjë vlerësimi dhe mirënjohjeje për përkushtimin e tyre të palëkundur në luftën kundër pandemisë COVID-19.

Më 10 qershor në Shkup u zhvillua evenimenti hibrid i nivelit të lartë "Autonomia trupore - themeli i të drejtave të njeriut", i organizuar nga **Fondi i Kombeve të Bashkuara mbi Popullsinë (UNFPA)**, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, Ministrinë e Shëndetësisë, Ambasadën e Francës, Zyrën e Presidentit dhe Zyrën e Koordinatorit të Përhershëm të OKB-së. Ky eveniment e shënoi njërin nga koalicionet e veprimit të Forumit të barazisë së gjeneratave, të bashkë-udhëhequr nga UNFPA-ja. - Koalicioni i veprimit për autonominë trupore dhe shëndetin dhe të drejtat seksuale dhe riprodhuese, partneriteti i ri i qeverive, përfshirë Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, shoqërinë civile, Kombet e Bashkuara dhe sektorin privat. Synimi i këtij koalicioni ishte promovimi i të drejtave të të gjitha grave dhe vajzave adoleshente. Evenimenti mund të ndiqet virtualisht në tri gjuhë - maqedonase, angleze dhe frënge.

Pas publikimit të raportit të [Trendeve Globale të vitit 2020](#) për zhvendosjen e detyruar, **Komisionari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët, ose agjencia e**

OKB për Refugjatët (UNHCR) e shënuan Ditën Botërore të Refugjatëve me aktivitetet e ndryshme për rritjen e ndërgjegjësimit, përfshirë paraqitje në media, siç ishte [intervista](#) që Përfaqësuesja e përhershme znj. Monika Sandri e dha për agjencinë e lajmeve MIA.



70 YEARS PROTECTING PEOPLE FORCED TO FLEE



UNHCR raportit të [Trendeve Globale të vitit 2020](#)

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) e ka rindërtuar kopshtin e vetëm në Komunën Shuto Orizari me mbështetjen e Mbretërisë së Norvegjisë, pasi ai ishte djegur në vitin 2017. Brenda kopshtit të rindërtuar gjendet Qendra për mbështetjen e përditshme për fëmijët në rrezik, që do të ofrojë kujdes dhe aktivitetet edukative për afërsisht njëqind fëmijë në rrezik midis moshave 5 dhe 13 vjeçare. Meqenëse gjatë pandemisë Maqedonia e Veriut krijoi procesin e mësimi në distancë, këta fëmijë në rrezik ishin lënë edhe një herë në mëshirë të fatit, gjë që ka rezultuar me braktisjen praktikave të tyre të të mësuarit, për shkak të mbylljes së shkollës dhe mungesës së pajisjeve të përshtatshme TIK për t'i lehtësuar aktivitetet arsimore në të ardhmen. Tani UNDP-ja po organizon një [iniciativë për financim](#) të gjerë për t'iu ofruar një mundësi fëmijëve në rrezik nga Shuto Orizari për ta vazhduar procesin e tyre mësimor, për të fituar aftësi të reja dhe për të qëndruar larg rrugëve.

Në kuadër të projektit GEF/STAR5, më 10 dhe 11 qershor të vitit 2021, **Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin Jetësor (UNEP)** në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor e organizuan modulin e fundit të trajnimit për rojtarë pylli. Trajnimi u zhvillua në hotelin "Scardus", në Kodër të Diellit si pjesë parkut të ardhshëm nacional, Malit Sharr. Trajnimi është përpiluar në veçanti në përputhje me nevojat për menaxhimin e zonave të mbrojtura.

Let's create a better future for at-risk children in North Macedonia

US\$2,304 / US\$15,000

15% OF GOAL | 27 SUPPORTERS | 42 DAYS LEFT

DONATE NOW

Tani UNDP-ja po organizon një [iniciativë për financim](#) të gjerë për t'iu ofruar një mundësi fëmijëve në rrezik

Strategjia Nacionale për Zhvillim 2021-41

Vizion i përbashkët dhe afatgjatë për zhvillim

Vlerësimi i Përbashkët i Vendit, i përgatitur në fillim të vitit 2020 me qëllim të krijimit të kontekstit të Kornizës së Bashkëpunimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm të OKB (UNSDCF) 2021-2026 për Maqedoninë e Veriut, e identifikoi mungesën e vizionit afatgjatë të zhvillimit si një nga sfidat kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm në vend. Menjëherë pas kësaj, kriza COVID-19 e transformoi realitetin tonë. Dobësitë për të cilat tashmë ishim të vetëdijshëm u ekspozuan edhe më tej, ndërsa edhe disa dobësi të reja dolën në shesh, megjithatë plotësisht ndryshoi mënyra se si ne mendojmë për të ardhmen tonë dhe si i adresojmë sfidat. Në këtë kontekst, një strategji afatgjatë e zhvilluar siç duhet, që e përcakton drejtimin e rrugëtimit brenda një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent, duke përfqatur inovacionin dhe fleksibilitetin për të ngjellë relevant për 20 vite, mund të jetë një mundësi e fortë për ta siguruar vazhdimësinë dhe stabilitetin e zhvillimit të rrugëtimit të Maqedonisë së Veriut.

Është për t'u admiruar fakti, që autoritetet nacionale shprehën angazhim të fortë për ta shfrytëzuar këtë mundësi, duke e filluar procesin e formulimit të një Strategjie Nacionale të Zhvillimit (SNZh) 2021-2041, të bazuar në katër parime kryesore. E para është sigurimi i një pronësie të fortë nacionale, me procesin e udhëhequr nga protagonistët kryesorë nacionale, përfshirë autoritetet shtetërore, botën akademike, biznesin dhe shoqërinë civile. E dyta është të sigurojmë konsultime të gjera dhe të hollësishme, duke punuar me një numër maksimal të palëve të interesuara për ta arritur dhe reflektuar konsensusin mes gjeneratave, konsensusin ndëretnik, ndërpartiak, gjeografik dhe gjinor. Përderisa procesi dhe strategjia duhet të ngjelin të gjërë dhe ndër-shoqëror, qeveritë në 20 vitet e ardhshme do të kenë një rol të rëndësishëm në përkthimin e prioriteteve në politika, testimin dhe hartimin e mënyrave më të mira për t'i arritur qëllimet afatgjatë të akorduara me konsensus. E treta është të sigurohet kornizë për proceset e vazhdueshme, përfshirë anëtarësimin në BE dhe Agjendën 2030, dhe të sigurohet mbështetje në vend të kopjimit të dokumenteve strategjike dhe iniciativave që ekzistojnë tashmë në vend. Dhe e katërta është të ngjelim inovativ, të mësojmë nga trendet, modelet dhe përvojat ndërkombëtare dhe t'i sistemojmë këto në kontekstin nacional për planifikimin strategjik.

Procesi ishte ndarë në dy faza për ta siguruar vëmendjen e duhur si për hartimin e metodologjisë ashtu edhe për procesin pasues të formulimit dhe zbatimit. Parlamenti, pushteti lokal dhe bota akademike ishte e përfshirë që në fillim të këtij procesi. Faza e parë ishte vendosur për ta zhvilluar një metodologji inovative dhe strukturë operacionale, që do ta zbatonte atë më së miri. Kjo fazë është përfunduar pothuajse brenda projektit të zbatuar nga UNDP-ja, me ndihmën financiare nga Mbretëria e Bashkuar, në të cilën një ekip i madh i ekspertëve ndërkombëtarë dhe nacionalë bëri analiza të gjera, të cilat rezultuan me një propozim për një metodologji të re dhe inovative dhe një kornizë operacionale, e cila i racionalizon dhe përtërin strukturat aktuale në vend që të krijojnë struktura të reja.

Metodologjia në fjalë e përdor si frymëzim modelin ekonomik "petulla" (doughnut) të Kate Raurth, kryesisht si një mjet për identifikim të rrezeve dhe mundësive gjatë horizontit kohor dhe për ndërtim të aftësive të rezistencës për trajtim të pasigurisë. Këto vlerësime të përsëritura do ta vendosin kontekstin për një rritje të thellë, d.m.th statusin në të cilin të gjitha dymbëdhjetë fondacionet shoqërore përbushen pa e tejkaluar ndonjë nga nëntë stadiumet ekologjike, që në ilustrim është zona e gjelbër midis dy rrethëve, e konsideruar si hapësirë e sigurt dhe e duhur për njerëzimin. Është mjaft me rëndësi të pranojmë që popullsia e shekullit 21 është një sistem i ngatërruar i flukseve dhe dobësive të ndërildhura, që kërkon transformim të thellë të kodit, duke ndërtuar

aftësi bashkëpunuese horizontale dhe vertikale në të gjithë shoqërinë. Në këtë kontekst, risia kryesore në metodologjinë e SNZh-së është se ajo e përcakton një proces të gjallë në zhvillim (në vend të vetëm një dokumenti) për të siguruar që vizioni të jetë po aq i rëndësishëm për 20 vjet sa do të jetë tani. Kjo do të arrihet në pesë hapa, duke filluar me i) përvetësimin e kuptimit (1-3 m); ii) përfytyrimin e të ardhmes (9-12m) dhe iii) vendimmarrjen (1-12m) formulimin e strategjisë e cila më pas vazhdon gjatë gjithë procesit të implementimit e shoqëruar me iv) eksperimentimin e politikave (v) të mësuarit dhe zhvillimit.

Struktura operative e propozuar i zgjeron dhe racionalizon strukturat ekzistuese në nivelin strategjik dhe operacional, por gjithashtu prezanton funksione të reja si Këshilli i Spirales së katërfishtë (Quadruple Helix) për konsultime, Inovacion në Politikë dhe Këshilltarët të të Dhënave, të koordinuara nga një njësi e SNZh-së brenda Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë. Një konsiderim i veçantë për pranimin në BE do të sigurohet përmes këshilltarit për BE. Procesi i konsultimeve dhe bashkëpunimit përfshin një platformë digjitale të

angazhimit dhe rreth 50 aplikacioneve brenda formatit Quadruple Helix të organizuar në një periudhë prej të paktën 9 muajsh në të gjithë vendin, për të siguruar pjesëmarrjen sa më të gjërë të palëve të interesuara. Kjo përfshin një komunikim aktiv, të vazhdueshëm dhe efektiv me publikun për të siguruar mirëkuptim të përbashkët, blerje dhe pjesëmarrje në çdo kohë.

Faza e dytë e projektit në fazën përfundimtare të përgatitjes duhet të fillojë menjëherë pasi metodologjia të miratohet nga palët përkatëse nacionale, d.m.th pjesa e dytë e vitit 2021. UNDP-ja do të vazhdojë ta zbatojë projektin dhe në bashkëpunim me Zyrën për Koordinim në vend do t'i vë në veprim njohuritë kolektive dhe tematike të të gjitha agjencive të OKB në shtet për të siguruar që iniciativat ekzistuese të zhvillimit të qëndrueshëm të jenë të përfshira brenda vizionit afatgjatë. Përveç Mbretërisë së Bashkuar, edhe disa partnerë dhe donatorë tjerë strategjikë, kanë treguar interes për të ofruar mbështetje.

Për më shumë në lidhje me temat përkatëse mund të lexoni [këtu](#) dhe [këtu](#).

NË FOKUS Përfundimi i pashtetësisë

Masat kufizuese të COVID-19 na bënë të ndihemi të pafuqishëm dhe e bënë pothuajse të pamundur për shumë prej nesh mbulimin e nevojave tona themelore. Mirëpo për personat pa shtetësi, kjo është një luftë e përditshme.

Kush janë personat pa shtetësi? Sipas Konventës së vitit 1954 në lidhje me statusin e personave pa shtetësi, person pa shtetësi është "ai/ajo që nuk konsiderohet si shtetas nga asnjë shtet". Shtetet e ruajnë të drejtën e pasqme për të vendosur se kush janë qytetarët e tyre, megjithatë është gjithashtu përgjegjësi e tyre të ndërmarrin reforma ligjore dhe politike, të cilat janë të nevojshme për të siguruar që njerëzit të mos ngjelin pa shtetësi. Cilat janë shkaqet e pashtetësisë? Mangësitë dhe konfliktet në ligjet për shtetësi janë një shkak kryesor i pashtetësisë: mungesa e regjistrimit të lindjeve mund t'i vëmë fëmijët në rrezik të pashtetësisë: shtajja e shteteve të reja dhe ndryshimi i kufijve gjithashtu mund të shpijë në situata të mungesës së shtetësisë. Personat pa shtetësi e kanë vështirë t'i përbushin të drejtat themelore siç janë arsimi, kujdesi shëndetësor ose puna e denjë për shkak të mungesës së dokumentacionit.

UNHCR-ja ia ka caktuar vetes një qëllim ambicioz për t'i dhënë fund pashtetësisë në botë deri në vitin 2024 përmes fushatës së saj #Përka (#Belong). Për ta përbushur këtë objekt, UNHCR-ja në konsultim me shtetet, agjencitë e OKB, organizatat ndërkombëtare dhe shoqërinë civile, zhvilloi një Plan Global të Veprimit që krijon një kornizë udhëzuese të 10 veprimeve që duhet të ndërmerren nga shtetet për t'i dhënë fund pashtetësisë. Në rrafshin global UNHCR-ja dhe UNICEF-i i kanë bashkuar forcat dhe kanë krijuar një koalicion që synon ta zhvillojë, zgjerojë dhe forcojë bashkëpunimin ndërkombëtar për ta rritur ndërgjegjësimin dhe për ta luftuar problemin e fshehur të pashtetësisë së fëmijëve. Ai synon gjithashtu ta promovojë të drejtën e çdo fëmije për të marrë shtetësi.

Në Maqedoninë e Veriut, popullsia në rrezik pa shtetësi përbëhet nga dy grupe: personat që nuk kanë regjistrim të lindjes dhe regjistrim civil, dhe personat me nënshtetësi të papërcaktuar për shkak të shpërbërjes së ish Jugosllavisë. Problemi me personat e padokumentuar shpesh trashëgohet nga brezi në brez, pasi që një person i paregjistruar nuk mund t'i regjistrojë fëmijët e tij/saj kur lindin. Sipas të dhënave të UNHCR-së dhe partnerit të saj ligjor, Shoqata e Avokatëve të Rinj Maqedonas, ka rreth 558 persona në rrezik të pashtetësisë të identifikuar nga të dy organizatat. Qeveria lëshoi një thirrje publike në vitin 2018 duke ftuar personat - që nuk kanë regjistrim të lindjes - të paraqiten në zyrën më të afërt të regjistrimit civil. Rreth 760 persona iu përgjigjën thirrjes dhe 250 prej tyre iu qartësua statusi. Në vitin 2020, Qeveria miratoi

një ligj mbi personat e regjistruar në regjistrat e lindjeve (lex specialis) si një zgjidhje e përkohshme për të mundësuar qasjen në katër të drejta (punësimi, mbrojtja sociale, arsimi dhe mbrojtja shëndetësore) për personat e identifikuar pas thirrjes publike, derisa të gëzojnë regjistrim të plotë civil. Nga dispozitat e këtij ligji kanë përfutur 250 persona.



Komisioneri i Lartë i OKB-së për Refugjatët, Filippo Grandi për këtë çështje ka deklaruar: "Me qëllim që të mbrojmë dhe shpëtojme jetë, ne i nxisim qeveritë ta zgjidhin pashtetësinë dhe të sigurohen që askush të mos ngjell pas." Duke marrë parasysh madhësinë e problemit dhe faktin që Maqedonia e Veriut është nënshkruese e të dy konventave për pashtetësinë, Konventës së vitit 1954 në lidhje me statusin e personave pa shtetësi dhe Konventës së vitit 1961 për zvogëlimin e pashtetësisë, UNHCR-ja beson fuqimisht se gjendja e pashtetësisë në vend është e menaxhueshme dhe mund të adresohet lehtësisht përmes iniciativave të duhura legjislativë, që do t'i regjistronin siç duhet individët në rrezik të pashtetësisë.

The latest version of the Sustainable Development Bulletin is available on UN North Macedonia website. For additional information, please contact rc-northmacedonia@un.org. Produced by the UN Resident Coordinator's Office in North Macedonia | 10 June 2021

www.un.mk